



BANKA E SHQIPËRISË

**VLERËSIMI I GJENDJES FINANCIARE
TË SISTEMIT BANKAR SHQIPTAR
PËR TREMUJORIN E DYTË TË VITIT 2004**

Vlerësimi i gjendjes financiare të sistemit bankar shqiptar për tremujorin e dytë të vitit 2004

Në tremujorin e dytë të vitit, aktiviteti bankar shënoi një rritje prej 580 milionë lekësh, nga 17.4 miliardë lekë që u evidentua rritja për tremujorin e parë të vitit. Ndikimin kryesor në rënien e ritmit rritës të aktiveve të sistemit e dhanë dy prej bankave të sistemit, me pakësimin e aktiveve të tyre respektivisht 2.2 miliardë dhe 1.2 miliardë lekë.

Tabelë 1. Totali i aktiveve dhe pesha e tij ndaj PBB-së.

Treguesit në miliardë lekë:	Dhjetor'99	Dhjetor'00	Dhjetor'01	Dhjetor'02	Dhjetor'03	Mars'04	Qershor'04
Totali i aktiveve (fund periudhe – stok)	249.5	270.8	318.5	339.3	373.6	391	391.6
Në % ndaj PBB-së (vjetore)	49.2	50.2	53.5	51.6	50.2	46.7 ¹	46.8

Vendimi i transferimit të kapitalit të Bankës së Kursimeve nga Banka e Shqipërisë u krye në datën 14.04.2004, dhe tremujori i dytë i vitit nuk njeh më banka me kapital shtetëror. Ky fakt kushtëzoi ndryshimin e kriterit mbi rigrupimin e bankave, i cili në vazhdim do t'i klasifikojë ato mbi bazën e madhësisë së aktiveve. Konkretisht, grupi i parë (G1) përfshin bankat, pesha e të cilave është nën 2 për qind e totalit të aktiveve të sistemit, grupi i dytë (G2) bankat me peshe më të madhe se 2 për qind dhe më të vogël se 7 për qind e aktiveve të sistemit dhe grupi i tretë (G3) bankat që tejkalojnë nivelin prej 7 për qind ndaj aktiveve të sistemit.

Sipas këtij kriteri, në tremujorin e dytë evidentohet grupi G1 me ndikimin kryesor në rritjen e aktiveve të sistemit prej 887 milionë lekë, ndërsa dy grupet e tjera shënojnë rënie respektivisht 31.2 milionë lekë dhe 276.1 milionë lekë.

Megjithëse tremujori i dytë njohu rritje të lehta të aktiveve të sistemit bankar, ecuria e këtij treguesi në vite vlerësohet e kënaqshme. Kështu, periudha qershor'03-

¹ Në fillim të vitit 2004, rënia e peshës së aktiveve ndaj produktit të brendshëm bruto shpjegohet me vlerën e lartë të këtij të fundit (837.4 miliardë lekë) të parashikuar për vitin 2004, sipas metodës së re llogaritëse.

qershor'04 prezantoi rritje të aktivitetit bankar me 9.3 për qind, ndonëse në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar² rritja ishte 13.9 për qind.

Gjithashtu, privatizimi i Bankës së Kursimeve parashikon rritjen e presionit të ushtruar mbi bankat për zgjerimin e aktivitetit të tyre, me qëllim ruajtjen e peshave në treg dhe zhvillimin e kriterëve konkurruese.

Struktura e aktiveve të sistemit bankar, sipas zërave kryesorë dallon:

“Veprimet me thesarin dhe ndërbankare” shënojnë tendencë në rënie ndaj totalit të aktiveve të sistemit dhe, në periudhën qershor'03–qershor'04, prezantojnë ritmin më të ulët rritës (prej 4.3 për qind). *Pesha në rënie e këtij grupi flet për rritje të diversifikimit të portofolit të sistemit bankar.*

Zëri **“Marrëdhëniet me Bankën Qendrore”** shfaq luhatje të lehta të peshës së tij ndaj aktiveve të sistemit (në intervalin 8.3 për qind - 9.1 për qind).

Struktura e aktiveve të sistemit bankar shqiptar vazhdon të evidentojë peshë të konsiderueshme të investimeve në bono thesari.

Gjithsesi, tendenca është në rënie dhe periudha qershor'03 - qershor'04 shënon ritmin më të ulët rritës, prej 3.2 për qind.

Ndërkohë, privatizimi i Bankës së Kursimeve mund të sjellë një ndryshim të rëndësishëm në strukturën e aktiveve të sistemit. Aktualisht, pesha e investimeve të sistemit në bono thesari është 49.7 për qind dhe Banka e Kursimeve zotëron 72.7 për qind të këtij zëri. Privatizimi i saj parashikon të shoqërohet me shtrirjen e bankës në kredihënie, që mund të rezultojë në zhvendosje të fondeve nga investimet në bono thesari në investime kredihënëse.

Zëri **“Marrëdhëniet me bankat e tjera”** përbën 15.4 për qind të aktiveve të sistemit bankar nga 22 për qind në të njëjtën periudhë të vitit 2000. Tendenca në rënie nuk ka të bëjë me reduktimin e aktivitetit ndërbankar, por me zgjedhjen e mundësive të reja të investimit nga bankat e sistemit.

Në pjesën e parë të vitit, kredihënja shënon rritje të peshës së saj ndaj aktiveve të sistemit në 14.5 për qind, nga 12.5 për qind një vit më parë. Ritmi i saj rritës me 26.6 pikë përqindjeje vlerësohet i kënaqshëm.

“Investimet në letrat e tjera me vlerë” ndonëse kanë reduktuar ritmin rritës në krahasim me një periudhë më parë, prezantojnë rritje të peshës ndaj aktiveve të sistemit. Një analizë më e detajuar e këtij portofoli dallon krahasueshmërinë e madhësisë së investimeve në obligacionet e qeverisë shqiptare (35% e totalit të letrave me vlerë) me ato të qeverive të huaja (33% e totalit të letrave me vlerë). Gjithashtu, sistemi bankar zotëron obligacione të emetuara nga banka të huaja, nga institucione të huaja financiare, nga korporata të huaja dhe nga organizata ndërkombëtare. Diversifikimi i këtij portofoli flet për zhvillimin e sistemit bankar drejt tregjeve të huaja dhe nënkupton njohjen e bankingut shqiptar me alternativat frytdhënëse të investimit.

² Periudha qershor'02-qershor'03.

Së fundi, “**Mjetet e qëndrueshme**” evidentojnë nivele të krahasueshme gjatë viteve. Pesha e tyre ndaj aktiveve të sistemit luhatet në intervalin 1.5-1.9 për qind.

Kredia e re e lëvruar në gjashtëmuorin e parë të vitit evidentohet **56.4 miliardë** lekë ose **34 për qind më e lartë se në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar**. *Ritmi rritës vlerësohet i kënaqshëm dhe tregon tendencat pozitive të sistemit bankar drejt zgjerimit të kredidhënies.*

Karakterizimi i kredidhënies nga “maturimi afatshkurtër” ka rezultuar në rritjen e tepicës së kredisë vetëm me 5.8 miliardë lekë ose 11.4 për qind në krahasim me fundvitin 2003. Gjithsesi, kredia afatshkurtër prezanton tendenca rënëse gjatë viteve të fundit, sikurse jepet në tabelën e mëposhtme:

Tabelë 2. Pesha e kredisë afatshkurtër ndaj totalit të tepicës së kredisë.

Sistemi bankar Treguesi në %	Qershor '02	Qershor '03	Dhjetor '03	Qershor '04
Kredia afatshkurtër.	52.2	45.5	40.3	28.8

Sistemi bankar evidenton zhvendosje të tepicës së kredisë afatshkurtër në kredi afatmesme dhe në kredi afatgjatë. Ky është një zhvillim i pritsëm në kushtet kur si bankat ashtu edhe klientët i perceptojnë më të mira kushtet e ekonomisë dhe kapacitetet e tyre për të analizuar më mirë rrezikun ndaj të cilit ekspozohen në një marrëdhënie kreditimi.

Struktura e kredisë sipas monedhave, shënon rënie të tepicës së kredisë në lekë, edhe në pjesën e parë të këtij viti.

Tabelë 3. Struktura e tepicës së kredisë sipas monedhave.

Sistemi bankar Treguesi në %	Qershor'02	Dhjetor'02	Qershor'03	Dhjetor'03	Qershor'04
Kredi në lekë	17.4	20.98	19.9	17.9	16.8
Kredi në valutë	82.6	79.02	80.1	82.1	83.2

Dominimi i kredisë në valutë shpjegohet me diferencat e ndjeshme midis normave të interesit për kredinë në lekë dhe për atë në valutë, megjithë uljen e kësaj difference në muajt e fundit. Bankat dhe klientët perceptojnë një nivel të ulët rreziku, në kushtet kur kjo mënyrë kreditimi preferohet nga kredimarrësit dhe ruhen normat respektive të mbikëqyrjes.

Politikat e Bankës së Shqipërisë ndaj reduktimit të normës bazë së interesit, synojnë edhe ngushtimin e gap-it midis interesit në valutë dhe atij në lekë.

Treguesi “kredi me probleme / tepricës së kredisë (bruto)” llogaritet në nivel më të ulët se në tremujorin e parë të vitit (4.3% kundrejt 4.7%). Gjithashtu, në tremujorin e dytë sistemi bankar regjistron “shpenzime për provigjone” prej 132 milionë lekësh, nga 500 milionë lekë për tremujorin e parë dhe treguesi “fonde rezervë për humbjet nga kreditë / teprica e kredisë (bruto)” llogaritet 3.3 për qind nga 3.7 për qind, në tremujorin e parë. *Tendenca në rënie e raporteve të mësipërm flet për cilësi të kënaqshme të investimeve të sistemit në kredidhënie.*

Në tremujorin e dytë, sistemi bankar prezantohet me fitim rreth 1 miliard e 346 milionë lekë, i cili është pak më i lartë krahasuar me tremujorin e parë, por më i ulët se e njëjta tremujori i dytë i vitit 2003. Nga analiza rezulton se sistemi bankar në këtë tremujor ka patur një performancë më të mirë në drejtim të aktivitetit kryesor sesa tremujorin e parë të vitit. Gjithashtu, edhe shpenzimet për provigjone kanë qenë disa herë më të ulëta duke u shfaqur si një shpjegues i rëndësishëm i dinamikës më pozitive të rezultatit neto në krahasim me një tremujor më parë.

Përsëri, elementet kryesore që kanë kontribuar në rezultatit neto të sistemit bankar dhe në dinamikën e tij krahasuar me periudhat e mëparshme konsistojnë në rezultatit nga aktiviteti kryesor dhe aktivitetet e tjera.

Tabelë 4. Ecuria e elementeve kryesore të rezultatit neto.

Treguesit në milionë lekë, fluks për tremujorin përkatës	Qershor '03	Mars '04	Qershor '04
Rezultati neto nga interesat	3,011.17	2,750.45	2,834.74
Rezultati neto nga veprimtaritë e tjera	487.99	866.45	699.41
Shpenzimet e veprimtarisë	1,430.24	1,535.76	1,720.86
Shpenzime për provigjone	53.44	500.39	131.81
Rezultati neto (pas tatimit)	1,601.54	1,204.49	1,346.12

Në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2003, sikurse u citua më sipër, rezultati neto paraqitet më i ulët si rrjedhojë e rezultatit neto më të ulët nga interesat dhe i shpenzimeve më të larta të veprimtarisë. Ndoshta, këtu është rasti për të theksuar që ky vrojtim mund të paraqesë në vetvete fenomene pozitive, të tilla si rritja e konkurrencës në sistemin bankar e cila mund shprehet si në formën e rënies së fitimit apo edhe të zgjerimit të aktivitetit të bankave në tërësi (reflektuar në nivelin më të lartë të shpenzime të veprimtarisë).

Nga analiza sipas grupbankave, grupi G3 i bankave evidenton një rezultat shumë të mirë prej 2,542 milionë lekësh, pasuar nga grupi G1 me rreth 75 milionë, ndërsa grupi G2 i bankave paraqet një rezultat neto negativ prej rreth 66 milionë lekësh.

Në këtë tremujor, kthyeshmëria nga aktivitet mesatare (ROA) në bazë vjetore rezulton në nivelin 1.32 për qind. Treguesi në fjalë vlerësohet i mirë dhe brenda kufijve të pranueshëm. Në krahasim me periudhat e mëparshme vërejmë një

qendrueshmëri të ROA, gjë që shprehet edhe nëpërmjet luhatshmërisë së ulët të saj dhe trendit në rritje respektivisht me 6 dhe 8 pikë bazë ndaj tremujorit të parë të vitit 2004 dhe fundit të vitit 2003.

Tregues tjetër i rëndësishëm i rentabilitetit, ROE, prezantohet i qëndrueshëm dhe me një trend të lehtë në rritje krahasuar me periudhat e mëparshme. Edhe për këtë tregues, ndikimi vjen nga rritja me ritme të larta e rezultatit neto në krahasim me kapitalin mesatar aksioner, ndërsa ky i fundit llogaritet rreth 0.7 për qind më i lartë se një periudhë më parë.

Për një panoramë më të qartë të rentabilitetit të sistemit bankar nga veprimtaria kryesore si edhe të dinamikës së ekuilibrit ndërmjet mbledhjes së burimeve për të cilat paguhet interes dhe të investimit në aktive që fitojnë interesa, më poshtë jepen tabelat 5 dhe 6.

Tabelë 5. Tregues të rentabilitetit nga veprimtaria kryesore.

Treguesit në përqindje	Qersh. '03	Mars '04	Qersh. '04
Të ardhura nga interesat / aktive mesatare që sjellin të ardhura (1)	8.50	7.18	7.05
Shpenzime për interesa / aktive mesatare që sjellin të ardhura (2)	5.11	4.18	4.04
Marzhi neto nga interesat (NIM)/[(1) – (2)]	3.39	3.00	3.01
Rezultati neto nga interesat	3,011.17	2,750.45	2,834.74

Tabelë 6. Tregues të rentabilitetit.

Treguesit në milionë lekë	Qershor '03	Mars '04	Qershor '04
Aktivet mesatare që sjellin të ardhura (1)	334,152.23	366,186.06	370,916.36
Pasivet mesatare që shkaktajnë shpenz. (2)	308,301.96	342,790.54	345,885.15
Aktivet mesatare (3)	349,138.01	383,379.48	387,548.90
(1) / (3)	0.96	0.96	0.96
(2) / (3)	0.88	0.89	0.89

Në fund të tremujorit të dytë të vitit niveli i **kapitalit aksioner** për sistemin shënon vlerën 23.3 miliardë lekë ose rreth 640 milionë lekë më shumë se në fund të tremujorit të mëparshëm. Në sistem dallojnë 9 banka (kryesisht të G1) me rënie të niveleve të kapitalit aksioner, ndërkohë që është Banka e Kursimeve me kontributin më të madh në kapitalin e sistemit. Kjo e fundit jep ndikimin kryesor edhe brenda grupit (G3) i cili njihet rritje të kapitalit aksioner (rreth 875 milionë lekë) krahasuar me tremujorin e parë, krahas dy grupeve të tjera (G1, G2) të cilat njohin rënie të niveleve të tij (rreth 235 milionë lekë).

Një vështrim në strukturën e kapitalit aksioner të sistemit shpjegon dhe kontributin e elementeve përbërëse në rritjen modeste të niveleve të tij. E cilësojmë modeste rritjen e kapitalit aksioner të sistemit, për faktin se kjo e fundit bëhet pothuaj në të njëjtat nivele si dhe në tremujorin e mëparshëm (rreth 670 milionë lekë). Në treguesin e sistemit³ *kapitali i paguar* vazhdon të ruajë peshën kryesore (67%) me një kontribut vetëm 335 milionë lekë, ndërkohë që *fitimi i periudhës ushtrimore* ruan

³ Kapitali aksioner.

ndikimin kryesor me rreth 1.3 miliardë lekë dhe rritja e *diferencave të rivlerësimit* ruan efektin negativ me rreth 800 milionë lekë në nivelet e kapitalit.

Tabelë 7. *Struktura e kapitalit aksioner.*

Treguesi	2003		2004		2004	
	Dhjetor		Mars		Qershor	
	në milionë lekë	në %	në milionë lekë	Në %	në milionë lekë	në %
Kapitali i vet aksioner	21 984.9	100.0	22 652.0	100.0	23 291.7	100.0
Kapitali i paguar ⁴	18 512.3	69.3	19 580.6	71.9	19 915.6	67.9
Rezervat	4 517.5	20.5	4 712.5	20.8	4 818.2	20.7
Diferenca rivlerësimi	-3 285.8		-3 303.6		- 4 102.9	
Fitimi (humbja)e pashpërndarë	-180.9		458.1	2.0	110.2	0.5
Fitimi (humbja) e vitit në vazhdim	2 422.0	10.2	1 204.6	5.3	2 550.6	10.9

Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit për sistemin bankar njih rënie, rreth 3 pikë për qindjeje. Kështu, nga 30.1 për qind që evidentohet ky tregues në tremujorin e mëparshëm, në periudhën që analizojmë ai (treguesi) evidentohet 27 për qind. Ndikimin kryesor në rënie e raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit e jep rritja e konsiderueshme e aktiveve të klasifikuara sipas rrezikut, me rreth 6.6 miliardë lekë ose rreth 10 për qind, ndërkohë që nivelet e kapitalit rregullator njohin rënie rreth 0.2 miliardë lekë ose 1 për qind⁵.

Analiza e raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit sipas grupbankave dallon nivelin më të lartë të treguesit në bankat e G1 dhe nivelin më të ulët në bankat e G2. Kjo

gjen shpjegim në faktin që bankat e G1 të cilësuar si banka “të vogla”⁶ ndonëse evidentojnë rritje të aktiveve me rrezik krahasuar me tremujorin e mëparshëm (rreth 1.5 miliardë lekë ose 17 për qind) vazhdojnë të ndërmarrin më pak aktivitete me rrezik krahasuar me dy grupbankat e tjera të sistemit. Ndërkohë bankat e G2 investojnë pjesën më të madhe të aktiveve të tyre në kredidhënie – aktiviteti më me rrezik për një bankë, por ruajnë dhe nivele modeste të kapitalit rregullator.

Treguesit e kapitalit ndonëse i evidentojnë bankat e sistemit mbi normën minimale të mjaftueshmërisë, dallojnë disa banka me nivele të afërta me ato të normës minimale të lejuar (12 për qind) dhe disa të tjera me nivele të kapitalit bazë nën ato minimale të kërkuara. Kjo e fundit do të diktonte nevojën e shtesës për kapital për bankat e sistemit me qëllim monitorimin më të mirë të rreziqeve që ndërmarrin ato (bankat).

⁴ Peshat në përqindje të kapitalit të paguar llogariten duke marrë në konsideratë edhe diferencat e rivlerësimit.

⁵ Ndikimin kryesor në rënie e niveleve të kapitalit rregullator e jep rritja e diferencave të rivlerësimit debitorë si element zbritës i kapitalit bazë.

⁶ Sipas madhësisë së aktiveve.

Niveli i *aktiveve likuide*⁷ ndaj totalit të aktiveve për bankat e sistemit edhe në tremujorin e dytë të vitit evidenton nivel të kënaqshëm si dhe gjatë tremujorit të mëparshëm. Ky tregues shënon nivelin mbi 37 për qind dhe flet për nivel të konsiderueshëm të aktiveve likuide në aktivet e bankave, ndërkohë që niveli shumë i lartë i tij për disa banka të sistemit flet për pasivitet të tyre në tregun e kredidhënies.

Po kështu, treguesi i *aktiveve afatshkurtra ndaj pasiveve afatshkurtra* për sistemin vazhdon të evidentojë nivel të kënaqshëm 104 për qind në këtë tremujor, ndonëse të shoqëruar me një rënie rreth 9.2 pikë përqindjeje krahasuar me tremujorin e mëparshëm. Ndikimin kryesor në rënien e treguesit e jep rënia e aktiveve afatshkurtra rreth 7 për qind (ose rreth 11 miliardë lekë), ndërkohë që pasivet afatshkurtra rriten rreth 1 për qind (ose 1.3 miliardë lekë).

Në mbyllje, sistemi bankar shqiptar edhe gjatë tremujorit të dytë të vitit vlerësohet në gjendje relativisht të mirë financiare.

⁷ Në zërin “aktive likuide” përfshihen: mjetet monetare, marrëdhëniet me BSH-llogari të tjera, bonot e thesarit, marrëdhëniet me bankat, institucionet e kreditit dhe institucione të tjera financiare dhe letrat me vlerë (neto).